



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°18/2022

Hagë, 12/05/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në çështjen z. *Hashim Thaçi dhe të bashkakuzuarit*, të premtën, më 6 maj, u dorëzua një version i redaktuar publik i vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me konfirmimin e aktakuzës së ndryshuar. Vendimi dhe aktakuza e ndryshuar mund të gjenden në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Në vijim të dorëzimit të vendimit të javës së shkuar që konfirmon aktakuzën e ndryshuar, më 10 maj 2022 u mbajtën paraqitjet vijuese të secilit prej të akuzuarve. Të gjithë të akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me akuzat e ndryshuara në aktakuzë.

Aktgjykimi në çështjen *Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj* do të shpallet të mërkurën, më 18 maj në orën 10:00, dhe mund të ndiqet në shqip, serbisht ose anglisht përmes transmetimit në faqen e internetit të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ose fizikisht nga galeria publike e DHSK-së.

Këshillojmë të bëhet regjistrim paraprak për gazetarët që dëshirojnë të përcjellin seancën nga galeria publike ose qendra e medias në ndërtesën e Dhomave të Specializuara të Kosovës. Për t'u regjistruar paraprakisht, ju lutemi dërgoni një email në adresën PUBLIC@scp-ks.org ku të shënoni emrin, organin e medias, datën e lindjes dhe numrin e pasaportës ose letërnjoftimit dhe në rreshtin e lëndës shënoni "Trial Judgment". Ju lutem bashkëlidhni një kopje të vlefshme të skanuar të kartelës së shtypit.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°18/2022

Hagë, 12/05/2022

Gjykimi në çështjen kundër z. Salih Mustafa rifilloi të mërkurën me dëshmitarin e katërmbëdhjetë dhe të pesëmbëdhjetë të Mbrojtjes, dje dhe sot.

Gjatë seancës së sotme, Trupi Gjykues në çështjen Mustafa lëshoi urdhrin gojor në të cilin caktoi të enjten, 26 maj 2022, datë të parashikueshme për përfundimin e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

**Pyetje nga gazetarët
Nuk pati pyetje**

